Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:


V E N D I M

Për vlerësim të ofertave të projektit "Shërbimet e transmetimit të Kuvendit dhe shërbime të tjera për Komunën e Rahovecit"

1. **Caktohet komisioni vlerësues për vlerësimin e ofertave në projektin: "Shërbimet e transmetimit të Kuvendit dhe shërbime të tjera për Komunën e Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623.18.001.2-3-6 të datës 26.03.2018, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Shadat Ukaj, kryesues
 - 1.2 Ekrem Bytyqi, anëtar
 - 1.3 Petrit Haxhijaha, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit, zyra e prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

U dërgohet:


1. Anëtarëve të komisionit,
2. Zyrës së Prokurimit dhe
3. Arkivit.



Smajl Latifi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/171/18
Me datë: 23.03.18
Rahovec


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 datës 29.03.2017, nenit, 2, nenit 4 paragrafi 4, dhe neni 11 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 dhe 1.8 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve, 01.Nr. 1830 të datës 07.05.2013, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Kërkesa me numër të protokollit 285, e datës 21.03.2018, e z. Xhemaj Sylka nga Rahoveci dhe ndahen mjete financiare në shumën prej 500.00€ (pesëqindë euro).
2. Mjetet ndahen për mbulimin e shpenzimeve për eventin, ngasja e biçikletave që do të mbahet me datë 31 mars 2018, me qëllim të promovimit të vlerave bujqësore dhe promovimi i bukurive natyrore dhe vreshtave të Komunës së Rahovecit.
3. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të zyrës së Kryetarit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Përfitueses së subvencionit dhe,***
- ***Arkiv***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/144/18

Me datë: 14.03.2018

Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 9 paragrafi 1.3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005-i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimi e koordinatorit për KKSBB-në

1. **Z. Skender Hamza**, Caktohet koordinatori për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.
2. Koordinatori i KKSBB-së ka për detyrë të koordinoi takimet e KKSBB-së, të përgatit dokumentet dhe materialet për të gjithë anëtarët e KKSBB-së, ashtu siç kërkohet nga kryesuesi i KKSBB-së dhe dërgimin e materialeve anëtarëve së paku 7 ditë para mbajtjes së takimit, në rast se kryesuesi thërret takim të jashtëzakonshëm ftesat dhe materialet ju ofrohen brenda ditës si dhe manë procesverbal gjatë takimeve të KKSBB-së.
3. Obligohet koordinatori i KKSBB-së që këto punë ti kryej duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset koordinatori i caktuar me këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U dërgohet:

1. *Koordinatorit z. Skender Hamza ,*
2. *Sekretarisë së Kuvendit dhe*
3. *Arkivit.*






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. i protokollit 01/180/18
Me datë: 29.03.18
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave në projektin “ **Furnizimi me pajisje, vegla përcjellëse dhe uniforma për zjarrfikës,** me Nr. Prokurimi: 623.18.006.1-2-1 të datës 28.03.2018, në përbërje prej:

- 1.1 Sami Boshnjaku, Kryesues
- 1.2 Destan Cena, Anëtar
- 1.3 Lulzim Veliu, Anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet :

- Anëtarët e komisionit
- Zyra e Prokurimit dhe
- Arkivi

Smail Latifi
Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/186/18

Me datë: 30.03.18

Rahovec, 2018

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008), nenit 7 Ligjit të Punës Nr- 03/L-212, (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës), me datë 01.12.2010, nenit 35 të Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-17/2011), nenit 5 shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ, MASHT Nr-08/2014, për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-arsimor dhe aftësues të datës: 25.02.2014, Kryetari i Komunës së Rahovecit në cilësinë e udhëheqësit më të lartë Administrativ pas shqyrtimit të raportit final të rekomanduar nga komisioni përzgjedhës i datës 23.03.2018, për plotësimin e pozitës Zëvendës drejtor i Shkollës Filllore e Mesme e Ulët “Isa Boletini” në Rahovec, merr këtë:

VENDIM

Për pranim në marrëdhënie pune

1. Z. Nehat Duraku nga Krusha e Madhe, zgjidhet në vendin e punës Zëvendës drejtor i Shkollës Filllore e Mesme e Ulët “Isa Boletini” në Rahovec, duke filluar punën nga data 03.04.2018.
2. Marrëdhënia e punës themelohet për periudhën kohore me kontratë 4 vjeçare (katër vjeçare).
3. I përmenduri në pikën I të këtij vendimi i caktohet koeficienti 7.2 poenë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe zyra e personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Duke u bazuar në raportin final dhe rekomandimin e bërë nga Komisioni përzgjedhës, gjatë intervistimit të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin e shpallur nga Drejtoria e Arsimit në gazetën Epoka e Re me datë 15 shkurt 2018, me numër protokollit Nr. 36, për plotësimin e vendit të lirë të punës Zëvendës drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Isa Boletini” në Rahovec dhe në bazë të pikëve të fituara nga komisioni intervistues si dhe pas zbatimit të plotë të procedurës së rekrutimit në të cilën ka aplikuar z. Nehat Duraku, andaj u vendos që Zëvendës drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Isa Boletini” në Rahovec të zgjidhet z. Nehat Duraku nga Krusha e Madhe.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë komisionit për ankese në Komunën e Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi

U dërgohet:

- **Nehat Duraku,**
- **Drejtorë për Arsim, dhe**
- **Arkivët.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. i protokollit 01/182/18
Me datë: 30.03.18
Rahovec


Në bazë të nenit 13, 16 dhe nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 4 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ për tatim në pronën e paluajtshme dhe nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E ANËTARVE TË BORDIT KOMUNAL PËR ANKESA
NË TATIM NË PRONËN E PALUAJTSHME

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni për anëtarët e Bordit Komunal për Ankesa në tatim në pronën e paluajtshme për Komunën e Rahovecit, në përbërje prej:
 - 1.1 Gjyle Gashi, Kryesues
 - 1.2 Ruzhdi Kabashi, Anëtar
 - 1.3 Fatmir Hoti, Anëtar
2. Anëtarët e Bordit kanë për detyrë që të dalin në teren, të shqyrtojnë dhe vendosin lidhur me Ankesat e qytetarëve për tatim në pronë të paluajtshme të cilat i drejtohen këtij Bordit.
3. Mandati i anëtarëve të Bordit është 1(një) vite nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Bordi do të kryej punët duke u bazuar në rregullativën në fuqi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen anëtarët e Bordit Komunal të Ankesave në tatim në pronë
6. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet :

- Anëtarëve të Bordit Komunal të Ankesave
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/146/18

Me datë: 19.03.18

Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit, 4 paragrafi 4, neni 8 pika 5 dhe 8, nenit 11 dhe nenit 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017 dhe rekomandimit të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për Nr. 890 datë 19.03.2018, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndarje të subvencioneve për ndihma momentale

1. **Miratohet** Rekomandimi i Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndihma momentale, në fushën e shëndetësisë dhe ndahen subvencione për 60 përfitues të cilët kanë plotësuar kriteret sipas Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 1427 të datës 28.04.2017.
2. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Shtojcë e këtij vendimi është lista prej 130 përfituesve të ndihmës momentale të rekomanduar nga komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave në shumë të përgjithshme prej 8.310.00€ (tetë mijë e treqindë e dhjetë euro).
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- *Përfituesve të ndihmës momentale,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *DSHPS-së, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/158/P
Me datë: 21.03.18
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neni 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit AD-HOC për konstatimin e vijueshmërisë në punë të punonjësve të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve në Komunën e Rahovecit

1. Caktohet komisioni AD-HOC për konstatimin e vijueshmërisë në punë të punonjësve të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve në Komunën e Rahovecit, në përbërje prej:
 - 1.1 Shemsie Deliu, kryesues,
 - 1.2 Ardian Rama, anëtar,
 - 1.3 Skender Hamza, anëtar,
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë vijueshmërinë në punë të punonjësve të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, hyrjet, daljet dhe respektimi i orarit të punës sipas përshkrimit të detyrave të punës dhe orarit të përcaktuar me Ligj dhe kontratë të nënshkruar mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi.
4. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës..

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DSHMS-së, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/155/18
Me datë: 26.03.18
Rahovec,

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 70 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L149, nenit 9, të Rregullores Nr.04/2011, për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neneve 74, dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të statutit të komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë

V E N D I M
Për caktimin e Komisionit disiplinor AD-HOC

1. **Caktohet** Komisioni Disiplinor AD-HOC për shqyrtimin e lëndëve disiplinore Nr.01.150/18 të datës 19.03.2018, ndaj Esat Hoti, zyrtar për taksa afariste pranë Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe lëndës disiplinore Nr. 01.149/18 të datës 19.03.2018 të z. Ymret Reshiti, udhëheqës i zyrës së personelit në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:

1.1 Bilbil Oruqi, Kryesues,
1.2 Ylfete Kryeziu, anëtare,
1.3 Arben Gashi, anëtar,
2. Detyrat e Komisionit disiplinor janë të përcaktuara në Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L149, dhe Rregullores Nr.04/2011, për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.
3. Obligohet komisioni që të veproj duke u bazuar në ligjet e aplikueshëm të Republikës së Kosovës.
4. Komisioni Disiplinor ka mandat vetëm për lëndë disiplinore të cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe puna e tyre përfundon pas marrjes së vendimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Njësisë së Personelit dhe,
- Arkiv





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. i protokollit 011/175/18
Me datë: 27.03.18
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008.) nenit 5 dhe 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor me Nr.04/L-174 të datës 31.07.2013, neneve 12 dhe 13 të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2015 të datës 11.11.2015, neneve 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komiteti Drejtues për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal në Komunën e Rahovecit, në përbërje:


- 1.1 Nënkyetar Fatmir Iska, Koordinator
- 1.2 Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Rumir Zhuniqi
Zëvendës koordinator,
- 1.3 Shef për Urbanizëm, Selim Metkamberi
- 1.4 Arkitekt për Urbanizëm, Shpejtim Mustafa
- 1.5 Zyrtare e Lartë për Mjedis, Bjondina Ramaj
- 1.6 Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Përparim Krasniqi
- 1.7 Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Avni Morina
- 1.8 Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Berat Duraku
- 1.9 Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë, Saranda Sallteku
- 1.10 Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Samir Mustafa
- 1.11 Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Afrim Limani
- 1.12 Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Artan Asllani
- 1.13 Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Afrim Oruqi
- 1.14 Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Ervin Hoxha
- 1.15 Drejtori i Drejtorisë për Inspektim, Besnik Hoti
- 1.16 Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Hasan Përboçi

2. Obligohet grupi punues që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi (Ligjin për Planifikim Hapësinor me Nr.04/L-174 të datës 31.07.2013 dhe Udhëzim Administrativ i MMPH me Nr.11/2015 të datës 11.11.2015).

3. Grupi punues do të përkujdeset për hartimin e **Planit Zhvillimor Komunal**, punën do ta fillojë menjëherë pas nënshkrimit të këtij Vendimi dhe punët duhet të përfundojnë brenda një afatit të arsyeshëm.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoritë tjera të Komunës.
5. Vendim hyni në fuqi në momentin e nënshkrimit.

U dërgohet:

- **Anëtarëve të grupit punues**
- **Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit**
- **Drejtoritë tjera të Komunës**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/167/18
Me datë: 23.03.18
Rahovec

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenin 5, të Ligjit Nr-03/L-068, për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenin 20, të Ligjit Nr-04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, dhe nenin 4, të udhëzimit administrativ, Nr-08/2014 të datës 25.02.2014 të lëshuar nga MASHT-i dhe konkursëve të shpallura nga Drejtoria e Arsimit, me datën 13.02.2018, me numër të protokollit, 36 dhe Konkursit të datës 27.02.2018 me numër të protokollit 45, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e panelit intervistues

1. **Caktohet paneli për intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar në konkursët me numër të protokollit 36 të datës 13.02.2018 dhe konkursit me numër të protokollit 45 të datës 27.02.2018, nga Drejtoria e Arsimit, për Drejtor dhe Zëvendës drejtorit të SHFMU "Isa Boletini" në Rahovec dhe Drejtorit të SHFMU "4 Dëshmorët" në Ratkoc, në këtë përbërje:**
 1. **Ardian Rama, Kryesues,**
 2. **Arben Gashi, anëtar,**
 3. **Anëtar i tretë vjen nga MASHT-i sipas UA, Nr. 08/2014 të datës 25.02.2014**
2. Detyrat e panelit intervistues është që të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin e cekura në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara bënë ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë, Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të shkollave sipas konkursit.
3. Obligohet paneli intervistues që punit ti kryej duke u mbështetur në ligjet dhe aktet tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës..
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

U dërgohet:

- **Anëtarëve të Panelit Intervistues,**
- **Përfaqësuesit të MASHT-it,**
- **DKA-së, dhe**
- **Arkivi**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/185/18

Me datë: 30.03.18

Rahovec, 2018

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008), nenit 7 Ligjit të Punës Nr- 03/L-212, (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës), me datë 01.12.2010, nenit 35 të Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-17/2011), nenit 5 shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr. 03/-L068 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ, MASHT Nr-08/2014, për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës-drejtorit të Institucionit Edukativo-arsimor dhe aftësues të datës: 25.02.2014, Kryetari i Komunës së Rahovecit në cilësinë e udhëheqësit më të lartë Administrativ pas shqyrtimit të raportit final të rekomanduar nga komisioni përzgjedhës i datës 23.03.2018, për plotësimin e pozitës Drejtor i Shkollës Filllore e Mesme e Ulët “Isa Boletini” në Rahovec, merr këtë:

VENDIM

Për pranim në marrëdhënie pune

1. Z. Sakip Kryeziu nga Rahoveci zgjidhet në vendin e punës Drejtor i Shkollës Filllore e Mesme e Ulët “Isa Boletini” në Rahovec, duke filluar punën nga data 03.04.2018.
2. Marrëdhënia e punës themelohet për periudhën kohore me kontratë 4 vjeçare (katër vjeçare).
3. Të përmendurit në pikën I të këtij vendimi i caktohet koeficienti 7.8 poenë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe zyra e personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Duke u bazuar në raportin final dhe rekomandimin e bërë nga Komisioni përzgjedhës, gjatë intervistimit të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin e shpallur nga Drejtoria e Arsimit në gazetën Epoka e Re me datë 15 shkurt 2018, me numër protokoll Nr. 36, për plotësimin e vendit të lirë të punës si drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Isa Boletini” në Rahovec dhe në bazë të pikëve të fituara nga komisioni intervistues si dhe pas zbatimit të plotë të procedurës së rekrutimit në të cilën ka aplikuar z. Sakip Kryeziu, andaj u vendos që Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Isa Boletini” në Rahovec të zgjidhet z. Sakip Kryeziu nga Rahoveci. Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë komisionit për ankese në Komunën e Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi

U dërgohet:

- Sakip Kryeziu,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/170/18
Me datë: 23.03.18
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63, 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005-i datës 29.03.2017, nenit 4 paragrafi 4, 5 neni 8 pika 5, nenit 11 dhe nenit 14 paragrafi 1.1 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017 dhe rekomandimit të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të bursave për student Nr. 90, datë 22.03.2018, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndarje të bursave për studentë për vitin akademik 2017/2018

1. **Miratohet** rekomandimi i Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të bursave për studentë, për 63 (gjashtëdhjetë e tre), përfitues të cilët kanë plotësuar kriteret sipas Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 1427 të datës 28.04.2017.
2. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të zyrës së Kryetarit.
3. Shtojcë e këtij vendimi është lista prej 63 përfituesve të bursave për vitin akademik 2017/2018, të rekomanduar nga komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave.
4. Shuma e përgjithshme për një përfitues të bursave do të jetë 500.00€ (pesëqind euro) për vitin akademik 2017/2018.
5. Obligohet Drejtoria për Arsim të përgatisë kontratat për secilin përfitues të bursës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.
7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- *Përfituesve të Bursave,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *Drejtorisë për Arsim, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. protokollit 01/183/18
Me datë: 30.03.18
Rahovec, 2018

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008), nenit 7 Ligjit të Punës Nr- 03/L-212, (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës), me datë 01.12.2010, nenit 35 të Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-17/2011), nenit 5 shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr. 03/-L068 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ, MASHT Nr-08/2014, për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo-arsimor dhe aftësues të datës: 25.02.2014, Kryetari i Komunës së Rahovecit në cilësinë e udhëheqësit më të lartë Administrativ pas shqyrtimit të raportit final të rekomanduar nga komisioni përzgjedhës i datës 23.03.2018, për plotësimin e pozitës Drejtor i Shkollës Filllore e Mesme e Ulët “4 Dëshmorët” në Ratkoc, merr këtë:

VENDIM

Për pranim në marrëdhënie pune

1. Z. Veli Hoti nga fshati Ratkoc zgjidhet në vendin e punës Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme e Ulët “4 Dëshmorët” në Ratkoc, duke filluar punën nga data 03.04.2018.
2. Marrëdhënia e punës themelohet për periudhën kohore me kontratë 4 vjeçare (katër vjeçare).
3. Të përmendurit në pikën I të këtij vendimi i caktohet koeficienti 7.8 poenë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe zyra e personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Duke u bazuar në raportin final dhe rekomandimin e bërë nga Komisioni përzgjedhës, gjatë intervistimit të kandidatëve të cilët kanë konkurrar në konkursin e shpallur nga Drejtoria e Arsimit në gazetën Epoka e Re me datë 28 shkurt 2018, me numër protokoll Nr. 46, për plotësimin e vendit të lirë të punës drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “4 Dëshmorët” në Ratkoc dhe në bazë të pikëve të fituara nga komisioni intervistues si dhe pas zbatimit të plotë të procedurës së rekrutimit në të cilën ka aplikuar z. Veli Hoti, u vendos që Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “4 Dëshmorët” në Ratkoc të zgjidhet z. Veli Hoti nga Ratkoci.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë komisionit për ankese në Komunën e Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi

U dërgohet:

- Veli Hoti,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivit.

